



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 632

Datë: 23/2/2024

Zyra e personelit

Mbështetur në nenin 36 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 16 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" (UP) shpall

KONKURS

për pranimin e njëqind e njëzet (120) praktikantëve në administratën e UP-së

Informatat e përgjithshme:

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" (UP) ka për qëllim që studentëve dhe të diplomuarave të tij t'iu ofrojë mundësi angazhimi në praktikë profesionale me pagesë më qëllim që aftësitë e tyre teorike t'i zërthejnë në praktikë në fusha të ndryshme profesionale e administrative.

Për këtë qëllim, UP ofron mundësi angazhimi të njëqind e njëzet (120) praktikantëve (studentë aktivë dhe të diplomuar) nën kushtet dhe kriteret si në vijim:

Lartësia e pagesës:	200 euro (bruto) në muaj;
Orari:	Fleksibil në koordinimin me menaxherin e linjës;
Kohëzgjatja:	Gjashtë (6) muaj për studentët, respektivisht një (1) vit për të diplomuarit;
Angazhimi i grupeve:	Grupi I (për studentë): 01.04.2024 – 30.09.2024; Grupi II (për studentë): 01.10.2024 – 31.03.2025; dhe Të diplomuarit: 01.04.2024 – 31.03.2025

Fusha e realizimit të praktikës do të caktohet pas përzgjedhjes, gjegjësisht në vartësi prej profilit të studimeve të kandidatit, nevojave dhe mundësive që ka universiteti.

Praktikantët, pas përfundimit me sukses të programit të punës praktike, do të pajisen me certifikatë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".

Kriteret për aplikim:

- Kandidati për punë praktike duhet të jetë student aktiv ose duhet t'i ketë kryer studimet në njërën prej njësive akademike të UP-së.

- Përparësi do të kenë kandidatët që nuk kanë përfituar nga programet e mëparshme të praktikës nga institucione ose organizata të tjera.
- Për qëllime të plotësimit të numrit të vendeve të punës praktike, sipas nevojës, UP do të organizojë një intervistë të shkurtë me kandidatët e interesuar.

Kandidatët e interesuar që të jenë pjesë e këtij programi të praktikës profesionale, duke bashkëngjitur pasqyrën e notave (ose diploma për të diplomuarit) mund të aplikojnë online në linqet: <https://sems.uni-pr.edu/> (studentët aktivë të UP-së) dhe <https://praktika.uni-pr.edu/> (të diplomuarit në UP).

Afati për aplikim: 26.02.2024 - 06.03.2024.

